31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkakuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;

- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundur. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 626-24-8441-5-1-1/C184

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | Kushtet dhe detyrimet |
|--------------------------------|------------------|--|
| Kushtet e Veçanta të Kontratës | 1. | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të dyja palëve kontraktuese. |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2. | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksion do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.1 | Gjuha e përdorur do të jetë gjuha: Shqipe. |

| | | |
|---|-----|---|
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 3. | Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Përgjegjësia e kontraktuesit është në rast të shkaktimit të dëmeve në persona, staf apo objekte për rreth. Operatori Ekonomik është përgjegjës për sigurimin e punëtorëve të tij dhe do të bartë të gjitha pasojat në rast të ndonjë lëndimi gjatë ekzekutimit të punëve të punëtorëve të tijë apo personave tjerë, gjatë transportit dhe kryerjes së punëve në vendpunishte. |
| Programi | 4. | Punët e parapara për këtë projekt do të ekzekutohen gjatë vitit 2024 dhe 2025. Gjatë vitit 2024 do të ekzekutohen punët në vijim: Punët e Pastrimit, Gërmimit dhe nivelizimit; Punët e Betonit dhe Armaturës dhe Punët e Hidroizolimit dhe termoizolimit të përshkruara në aneksin nr. I të dosjes së tenderit, përshkrimin e çmimit dhe dhe planit për ekzekutim të kontratës. Gjatë vitit 2025 do të ekzekutohen punët në vijim: Punët e Betonit dhe Armaturës; Punët e muratimit dhe pllafonit; Punët e Kulmit dhe llamarines dhe Punët e Hidroizolimit dhe termoizolimit të përshkruara në aneksin nr. I të dosjes së tenderit, përshkrimin e çmimit dhe planit për ekzekutim të kontratës. Kurse në vitin 2026 do të ekzekutohen punët në vijim: Punët e muratimit dhe pllafonit; Punët e suvatimit, lyerjes dhe fasades se jashtme; Punët e Kulmit dhe llamarines; Punët e qeramikave, laminatit dhe mermerit; Punët e dyerve, dritareve dhe fasades strukturale; Punët e Oborrit; Punët e Tjera ; PUNËT E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT; HIDRANTËT; ELEMENTET SANITARE; ELEKTRIKA; TRUPAT NGROHËS FTOHËS DHE TUBACIONI; VENTILIMI dhe ASHENSORI të përshkruara në aneksin nr. I të dosjes së tenderit, përshkrimin e çmimit dhe planit për ekzekutim të kontratës. |
| Inspektimi dhe testimi | 5. | Menaxheri i Projektit: Menaxheri i projektit dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i projektit do të caktohet me vendim nga ana e kryetarit të Komunës. Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) sipas nenit 3 të Memorandumit të Mirëkuptimit do të caktoj një zyrtar për mbikëqyrjen e realizimit të projektit nga fillimi deri në përfundim të kontratës të cilit me vendim do t'i caktohen detyrat, përgjegjësitë dhe autorizimet për mbikëqyrje. Gjithashtu edhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) sipas nenit 4 të Memorandumit të Mirëkuptimit do të caktoj një zyrtar për mbikëqyrjen e realizimit të projektit nga fillimi deri në përfundim të kontratës të cilit me vendim do t'i caktohen detyrat, përgjegjësitë dhe autorizimet për mbikëqyrje. |
| Fillimi i punëve | 6. | Data e fillimit të punimeve sipas planit dinamik të kontraktuesit do të jetë me: 20.12.2024 |
| Përfundimi i punëve | 6.1 | Punët do të ekzekutohen në bazë të planit dinamik të cilin e ka paraqitur kontraktuesi në tenderin e tij. Ditët e punës do të llogariten sipas regjistrimit në ditarin e punës. - Plani dinamik i punëve për gjithë projektin është jo më shumë se dyqindnëntëdhjetë (290) ditë pune. Për punët të cilat do të ekzekutohet në vitin 2024 është jo më shumë se dyzetë (40) ditë pune. Për punët të cilat do të ekzekutohet në vitin 2025 është jo më shumë se njëqind e pesëdhjetë (150) ditë pune .Kurse për punët të cilat do të ekzekutohen në |

| | | |
|--|-----|---|
| | | vitin 2026 është jo më shumë se njëqind (100) ditë pune. |
| Përmirësimi i defekteve | 7. | Periodha për përmirësimin e defekteve është 5 ditë pas dorëzimit të kërkesës (Vërejtjes) nga ana e Organit Mbikëqyrës të kontratës. |
| Fillimi i realizimit të punëve (dorëzimi i vend punishtes) | 8. | Data e posedimit të vend punimit do të jetë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës. Plani i menaxhimit të kontratës do të bëhet brenda 5 ditëve pas nënshkrimit të kontratës. |
| Dëmet e likuiduara | 9. | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [0,25%] në ditë, të punëve të pa dorëzuara/realizuar për një ditë vonese. Autoriteti Kontraktues mund t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës. |
| Garacioni i kualitetit të punëve | 10. | Garacioni i kualitetit të punëve do të jetë 24 muaj. Pas përfundimit të punimeve para pagesës për secilin situacion, kontraktuesi duhet të sjellë garancionin për kualitet të punimeve në vlerë 10% të shumës së përgjithshme të situacionit të vlefshëm për 25 muaj. |
| Parapagimi | 11. | Shuma e Parapagimit është: <i>N/A</i> |
| Mbajtja e Parasë | 12. | Shuma e parave të mbajtura është: <i>N/A</i> |
| Pagesa e mjeteve | 13. | Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në pajtim me nenin 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit duhet t'ia paguajnë Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate me të cilën vërteton pjesën e përfunduar të punëve të ekzekutuar sipas kontratës. |
| Siguria e ekzekutimit | 14. | Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 192,342.30 € . Kontraktuesi do ta dorëzojë sigurinë e ekzekutimit para nënshkrimit të kësaj kontrate për kohëzgjatjen e periudhës prej njëzetepesë 25 muajve . |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës | 15. | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja të cilën e nxjerrë Menaxheri e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë i menaxherit të projektit pas kontrollimit dhe vlerësimit të punëve të mbetura pa u përfunduar sipas kësaj kontrate dhe specifikimeve teknike në dosje të tenderit. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 16. | Palët do të tentojnë që ti zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje palët do ta njoftojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e mosmarrëveshjes dhe do të sugjerojnë palës tjetër mbi variantin e zgjidhjes së kësaj mosmarrëveshje. |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 17. | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. |



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
 MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
 OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Mamushë

Përshkrimi i Çmimit

626-24-8441-5-1-1

626-24-020-5-1-1

Arkitektura

| | Pozicioni | Njësia | Sasia | Çmimi për njësi me TVSH € | Çmimi total me tvsh € |
|--|--|----------------|-----------|---------------------------|-----------------------|
| <p>Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të njerëzve dhe të kihen kujdes të veçantë të kalimi i personave afër punështes. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punështes dhe vendosjes së materialeve në të. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punështes. Punishja të rrethohet me tabela prej llamatine dhe me konstrukcion të forcuruar mirë në toke me shenja adekuate për sinjalizim të punëve në punështes</p> | | | | | |
| 1 | Punët e Pastrimit, Gërmimit dhe Nivelizimit | | | | |
| 1 | Pastrimi i komplet hapësirës të ku do të ndërtohet objekti. Të parashihet dhe pastrimi i hapësirave të oborrit nga drunjët, shkurret dhe mbeturina të ndryshme. | komplet | 1.00 | 45,000.00 | 45,000.00 € |
| 2 | Rrethimi i trualilit për ndërtimin e objektit dhe shenjëzim informativ. lartësia e rrethojës duhet të jetë ~ 2.0m Në hyrje të objektit duhet vendoset tabela me të dhënat e punekryesit,investitorit si dhe të dhënat tjera përkatëse. | m ² | 345.00 | 70.00 | 24,150.00 € |
| 3 | Vendosja e shenjave sinjalizuese në rrugë dhe sigurimi për mbarrvajtje të rregullt të qarkullimit të veturave për njëri shirit gjatë punimeve me makineri të rënda, për gërmim, betonim si dhe furnizime tjera | komplet | 1.00 | 10,000.00 | 10,000.00 € |
| 4 | Ndërtimi i zyrës së përkohshme të administratës dhe rojes. Zyre me dy hapësira me sipërfaqe ~ 20.0m ² | m ² | 20.00 | 400.00 | 8,000.00 € |
| 5 | Rrafshimi i terrenit heqja e humusit si dhe transportin deri në depo në largësi jo më të vogël se 5 km. Në çmim përfshihet edhe ngjeshja. | m ³ | 1500.00 | 20.00 | 30,000.00 € |
| 6 | Gërmimi i dheut të kategorisë së tretë dhe ka erte për lthemele, kjo përfshinë edhe transportin deri në depo në largësi jo më të vogël se 5 km Në çmim përfshihet edhe ngjeshja min. 8 Mpa. | m ³ | 4200.00 | 15.00 | 63,000.00 € |
| 7 | Furnizimi dhe shtruarja e gurit të thyer fr.0-150mm , kjo përfshin edhe ngjeshjen e tij. (Vërejtje: Në çmim duhet të llogaritet edhe shqyrtimi i njeshjes nga ekipi i specializuar për këtë lëmi-min. 60MPa) | m ² | 1950.00 | 12.00 | 23,400.00 € |
| 8 | Furnizimi dhe shtruarja e zhavorit fr.0-63mm ,kjo përfshin edhe ngjeshjen e tij. (Vërejtje: Në çmim duhet të llogaritet edhe shqyrtimi i njeshjes nga ekipi i specializuar për këtë lëmi-min. 80MPa) | m ³ | 2100.00 | 18.00 | 37,800.00 € |
| 9 | Furnizimi dhe shtruarja e zhavorit fr. 0-31mm, kjo përfshin edhe ngjeshjen e tij. (Vërejtje: Në çmim duhet të llogaritet edhe shqyrtimi i njeshjes nga ekipi i specializuar për këtë lëmi-min. 100MPa) | m ³ | 980.00 | 22.00 | 21,560.00 € |
| Totali: | | | | | 262,910.00 € |
| 2 | Punët e Betonit dhe Armaturës | | | | |
| 1 | Furnizimi dhe betonimi i betonit të vdekur C15/13 në dy shtresa me nga 5cm, me hidrolizim në mes | m ³ | 225.00 | 115.00 | 25,875.00 € |
| 2 | Furnizimi dhe betonimi në tere konstrukcionin e objektit me beton të klases C-30/37. Në llogari hyjnë edhe punimet e kallupimit | m ³ | 2358.00 | 115.00 | 271,170.00 € |
| 3 | Furnizimi dhe punimi i armatures S-500 sipas datave të teknike | kg | 220546.00 | 1.60 | 352,873.60 € |
| Totali: | | | | | 649,918.60 € |

| | | | | | |
|----------------|---|----------------|---------|-------|-------------|
| 1 | Furnizimi me material dhe montimi i hidroizolimit të ftohtë (Ardex ose ngjashëm) në dysheme të nryeve sanitare, kuzhines si dhe në ngritje në mure në lartësi minimale 150 cm, kjo përfshinë tharjen e dyshemesë, llogaritja me m ² të sipërfaqes së punuar. | m ² | 160.00 | 8.00 | 1,280.00 € |
| 2 | Punimi i hidroizolimit në bazamentin e themel pllakes | m ² | 1655.00 | 30.00 | 49,650.00 € |
| 3 | Furnizimi me material dhe montimi i stirodunit të presuar N4 në dysheme me trashësi 2+2 cm. | m ² | 3460.00 | 2.00 | 6,920.00 € |
| 4 | Furnizimi me material dhe shtruarja e eslin betonit me trashësi 5 cm, me armature rrethë Ø4/15 cm dhe PV Folie | m ² | 3460.00 | 6.00 | 20,760.00 € |
| Totali: | | | | | 78,610.00 € |
| 7 | Punët e qeramikave, laminatit dhe mermerit | | | | |
| 1 | Furnizimi dhe instalimi i pllakave të dyshemesë nga porcelani Klasi i parë, dy herë të pjekura, sipas EN 14411:2004(ISO 13006), Rezistenca ndaj abrazionit të përbush kushitet sipas UNI EN ISO 10545-6. Rezistenca ndaj Ngricave duhet të jetë grupit B1a Klasa (UGL) sipas UNI EN 14411, Apsorbimi i ujit duhet të jetë më e ulët se 0.5%. Rezistenca ndaj acideve dhe bazave sipas NI EN ISO 10545-13. Vendosja e pllakave duhet të bëhet konform Standardit EN 13888. Në cmim duhet të përfshihen edhe këndoret e Aluminit, ngjitsi, dhe të gjitha punët tjera të nevojshme për të arritur produktin final. | m ² | 1685.00 | 15.00 | 25,275.00 € |
| 2 | Furnizimi dhe instalimi i pllakave të murit nga porcelani Klasi i parë, dy herë të pjekura, sipas EN 14411:2004(ISO 13006), Fortësia min. 50N/mm ² sipas UNI EN ISO 10545-4. Rezistenca ndaj abrazionit të përbush kushitet sipas UNI EN ISO 10545-6. Rezistenca ndaj Ngricave duhet të jetë grupit B1a Klasa (UGL) sipas UNI EN 14411, Apsorbimi i ujit duhet të jetë më e ulët se 0.5%. Rezistenca ndaj acideve dhe bazave sipas NI EN ISO 10545-13. Vendosja e pllakave duhet të bëhet konform Standardit EN 13888. Në cmim duhet të përfshihen edhe këndoret e Aluminit, ngjitsi, dhe të gjitha punët tjera të nevojshme për të arritur produktin final. Dim 25*60 cm ; 33*33 cm | m ² | 860.00 | 15.00 | 12,900.00 € |
| 3 | Furnizimi dhe montimi i laminatit me trashësi 12 cm, duke përfshirë edhe llajset dhe foljen | m ² | 750.00 | 8.00 | 6,000.00 € |
| 4 | Furnizimi dhe punimi i sollobankave nga graniti me trashësi 2cm | m ² | 430.00 | 30.00 | 12,900.00 € |
| Totali: | | | | | 57,075.00 € |

| 5 Punët e Kulmit dhe Ilamarinës | | | | | |
|--|---|----------------|----------|----------------|---------------------|
| 1 | Furnizimi me material dhe punimi i konstruksionit të kulmit dhe pjesës mbajtëse të tribunes nga material i çeliku me ankerimin e nevojshëm në përgjithësi sipas rregullave teknike në trajtë të betonit. Prerja saldimit, përgjithja dhe montimi i konstruksioneve metalike duke përfshirë (ankerat, bulonat, pllakat lidhëse) si dhe ngjyrosja e profileve me ngjyrë për mbrojtje ndaj korozionit minimum 2 shtresa si dhe ngjyrosja me ngjyrë për metale min. 2 shtresa. Gjithashtu në këtë pozicion përfshihet vendosja e Brinakeve dhe shtangimet e nevojshme sipas projektit | kg | 95150.00 | 3.00 | 285,450.00 € |
| 2 | Furnizimi, transporti dhe montimi i mbulesës së kulmit me sendviç panel, trashësia e sendviçit t=100 mm, ngjyra RAL të përzgjedhur nga O. mbyqyrës), rezistenca ndaj korozionit dhe ndikimeve tjera të ambientit. Të jepet forma (gdhendja) e sendviç panelit sipas skicës së dhënë në detaje, si dhe të bëhet mveshja izoluese e pjesës së prerë, me shini rezistent ndaj ndikimeve të jashtme, para mveshjes finale me lamarinë. Lidhja dhe montimi i paneleve të sendviçit të bëhet me bulona përkatëse për sendviç panel që do të lidhen me elementet e konstruksionit nga çeliku. | m ² | 550.00 | 30.00 | 16,500.00 € |
| 3 | Furnizimi dhe izolimi i kulmeve të rrafshëta me membranë Hidroizoluese PVC në rrota t=1.8mm në përputhje me standardet DIN 16 734: (preferohet: Cosmofin FC, Villas "ose ekuivalent"). Në pozicion-çmimi të parashihen punët me shtresa: -beton për ramje 4-16cm, (nga poshtë) -folie difuzive 200gr/m ² , -pllaka nga Polisteri XPS (stirodur), t=10cm, -geotextil 200gr/m ² , -membrana hidroizoluese t=1.8mm, -geotextil 300gr/m ² , -zhavorri i lumit (16x32mm) t=10cm (nga lartë). -Atika të izolohet me getextil, membrane hidroluese t=1.8mm, geotextil, -Rigolla për transportin e ujit deri në ujëmbledhës L=100.0m' Membrana në murin e atikes ankerohet me bulona dhe shiritin nga lamarina. Membranat përputhen (mbisaldohen) mes vete me temperaturë, këndoret e jashtme dhe të brendshëm të parafabrikuar, elementet e ullkëve dhe të gjitha materialet tjera të jenë me kualitet të prodhimit sipas ISO 9001. Llogaritet në m ² . | m ² | 1120.00 | 50.00 | 56,000.00 € |
| 4 | Furnizimi dhe montimi i lamarinës së plastifikuar me gjërësi të zhvilluar deri në 150 cm për mbulimin e atikes dhe sipërfaqeve tjera të nevojshme | m ² | 350.00 | 15.00 | 5,250.00 € |
| 5 | Furnizimi dhe punimi i olluqeve horizontale dhe vertikale Ø 100 mm si dhe ankerimet e nevojshme | m ² | 550.00 | 15.00 | 8,250.00 € |
| 6 | Furnizimi, transporti dhe montimi i kulmit (LANTERNA) me xham nga fasada strukturale me të gjitha elementet përcjellëse, me kapaka dhe gome silikon që përballon temperaturat +80°C dhe -60°C me struktura të xhamit prej 4 shtresave, xhami sipër i perber nga xhami dyshtrësor (lameluar-xham i sigurisë) 4+4 me folje si dhe xhami i poshtëm dyshtrësor (lameluar) 4+4 me folje mbrojtëse kundër demtimeve nga kushtet atmosferike. Konstruksioni i perber nga profilat alumini "ALUMIL" ose të ngjashëm me standarde DIN, EN, ISO 9001, me madhësi të profilet 55x55mm në horizontale si dhe profilat vertikal 100x50mm me barriera termike të plastikës (PVC) si dhe 3 lloje të gomave të ndryshme që përballon temperaturat dhe kushtet atmosferike të natyrës. | m ² | 105.00 | 180.00 | 18,900.00 € |
| | | | | Totali: | 390,350.00 € |
| 6 Punët e Hidroizolimit dhe termozolimit | | | | | |

| | | | | | |
|----------|---|----------------|--------|----------------|---------------------|
| 8 | Punet e dyerve, dritareve dhe fasades strukturale | | | | |
| 1 | Furnizimi dhe montimi i dyerve nga Druri i lameluar per perdorim te shpesht, me shtoka metalik mire te perforcuar. | | | | |
| 1.1 | 70x190 | copë | 1 | 550 | 550.00 € |
| 1.2 | 90x240 | copë | 11 | 500 | 5,500.00 € |
| 1.3 | 100x240 | copë | 15 | 650 | 9,750.00 € |
| 2 | Furnizimi dhe montimi i dyerve rreshqitese ne nje drejtim nga Druri i lameluar per perdorim te shpesht, me shtoka metalik mire te perforcuar . | | | | |
| 2.1 | 310x240 | copë | 3 | 850 | 2,550.00 € |
| 2 | Furnizimi dhe montimi i dyerve flutuese nga Druri i lameluar per perdorim te shpesht, me shtoka metalik mire te perforcuar . | | | | |
| 2.1 | 200x240 | copë | 5 | 750 | 3,750.00 € |
| 3 | Furnizimi dhe montimi i dyerve Emergjente | | | | |
| 3.1 | 100x220 | copë | 8 | 650 | 5,200.00 € |
| 4 | Furnizimi dhe montimi i dyerve nga alumini sebashku me pjeset fikse te saj | | | | |
| 4.1 | 100x230 | copë | 2 | 850 | 1,700.00 € |
| 4.2 | 200x300 | copë | 1 | 2500 | 2,500.00 € |
| 4.3 | 540x300 | copë | 3 | 5500 | 16,500.00 € |
| 5 | Furnizimi dhe montimi i dyerve rotuluese nga alumini sebashku me pjeset fikse te saj | | | | |
| 5.1 | 300x230 | copë | 2 | 3200 | 6,400.00 € |
| 6 | Furnizimi dhe montimi i dritareve nga alumini sebashku me pjeset fikse te saj | | | | |
| 6.1 | 80x60 | copë | 9 | 550 | 4,950.00 € |
| 6.2 | 80x150 | copë | 35 | 650 | 22,750.00 € |
| 6.3 | 350x300 | copë | 3 | 3600 | 10,800.00 € |
| 6.4 | 365x300 | copë | 4 | 3800 | 15,200.00 € |
| 6.5 | 250x70 | copë | 4 | 650 | 2,600.00 € |
| 7 | Furnizim me të gjitha materialet e nevojshme dhe montimi i Fasades Gjysëm Strukturale nga Profila Alumini dhe Xhami i lameluar komplet me mekanizem dhe pajisje përkatese për hapje-mbyllje kualitative, Xhamit , Solbanka e Aluminit, Llamarinat, etj | | | | |
| 7.1 | 760x350 | copë | 1 | 15000 | 15,000.00 € |
| | | | | Totali: | 125,700.00 € |
| 9 | Punet e Oborrit | | | | |
| 1 | Furnizimi me material dhe ngjeshja e zhavorit 0-150 mm trashesi 30 cm | m ³ | 180.00 | 3.00 | 540.00 € |
| 2 | Furnizimi me material dhe ngjeshja e zhavorit 0-60 mm trashesi 20 cm | m ³ | 120.00 | 3.00 | 360.00 € |
| 3 | Furnizimi me material dhe ngjeshja e zhavorit 0-31.5 mm trashesi 10 cm | m ³ | 60.00 | 3.00 | 180.00 € |
| 4 | Furnizimi, transporti dhe punimi i asfaltit nga materiali njëtrajshëm BZH 22 me trashësi l=8,0 cm dhe AB 11 me trashësi l=4,0cm në hapësirën e oborrit sipas projektit duke përfshirë lyerjen me emulsion 0,50kg/m ² . Verëjtje: Ne kete pozicion parashihet te asfalti në dy shtresa, duke parapare punet tjera qe te realizohet ky pozicion. | m ² | 650.00 | 7.00 | 4,550.00 € |
| 5 | Furnizimi me material dhe vendosja e anesoreve nga betoni ne trashesi 6 cm mbi bazen prej betoni te parapergatitur | m ² | 255.00 | 5.00 | 1,275.00 € |
| 6 | Furnizimi me material dhe punimi i barit te gashem neper oazat e percaktuara ne brendesi dhe jashte | m ² | 455.00 | 1.00 | 455.00 € |
| 7 | Furnizimi dhe vendosja e drunjeve dekorativ shumeveqar me ngjyra te ndryshme neper oazat e brendshme dhe te jashtme | copë | 55.00 | 5.00 | 275.00 € |
| 8 | Furnizimi dhe vendosja e shkurreve shumeveqare ne oazat e jashtme | copë | 35.00 | 5.00 | 175.00 € |
| | | | | Totali: | 7,810.00 € |

| 10 Punët e tjera | | | | | |
|------------------|--|----------------|--------|----------------|--------------------|
| 1 | Furnizimi dhe montimi i uleseve te AUDITORIUMIT me fiksim ne dysheme. - Dimensioni i gabaritit te uleseve: a/b/h =540/670/900 mm. - Lartesia e uleses: h=440 mm - Konstrukt i uleses dhe mbesheteses te jete nga kallope alumini dhe skelet nga profile celiku. - Kembet nga profili 40x60x1,5 mm dhe pjesët e lidhjes me dyshemenë nga fletë të paktën 2 mm e cila është e formuar nga kallope. Korniza metalike nën mbeshetëse e mbuluar me madf dhe pëlhurë të laminuar. Mbeshetja e krahut prej druri të lëmuar nga materiali ahu. - Mbeshjetesja e uleses: Pëlhura e tapiceri është 100% poliestër, ka rezistencë ndaj fërkimit, jo të ndezshme dhe ka veti qëndrueshmërie. Forca e fërkimit: 60,000 cikle. Peshë: 285 gr / m2. | copë | 360.00 | 25.00 | 9,000.00 € |
| 2 | Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave te Armstrongut sebashku me konstruksionin mbajtës sipas pamjes 3D me dimensione 120x60 cm | m ² | 150.00 | 6.00 | 900.00 € |
| 3 | Furnizimi dhe punimi i hapësirës së brendshme te plafonit me dru te lameluar me dimensione 5x10cm duke e parapare fiksimin e drurit ne platon | m ² | 45.00 | 10.00 | 450.00 € |
| | | | | Totali: | 10,350.00 € |

| Nr | | Rekapitulim Arkitektura | |
|----------------------------|---|-------------------------|-----------------------|
| 1 | Punët e Pastrimit, Gërmimit dhe nivelizimit | | 262,910.00 € |
| 2 | Punët e Betonit dhe Armaturës | | 649,918.60 € |
| 3 | Punët e muralimit dhe plafonit | | 101,150.00 € |
| 4 | Punët e suvalimit ,lyerjes dhe fasades se jashtme | | 105,221.00 € |
| 5 | Punët e Kulmit dhe llamarinës | | 390,350.00 € |
| 6 | Punët e Hidroizolimit dhe termoizolimit | | 78,610.00 € |
| 7 | Punët e qeramkave, laminatit dhe mermerit | | 57,075.00 € |
| 8 | Punët e dyerve, dritareve dhe fasades strukturale | | 125,700.00 € |
| 9 | Punët e Oborrit | | 7,810.00 € |
| 10 | Punët e tjera | | 10,350.00 € |
| Totali Arkitektura: | | | 1,789,094.60 € |

HIDROINSTALIMET

| 1 | PUNËT E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT | Njësia | Sasia | Çmimi për njësi me TVSH € | Çmimi total me tvsh € |
|------|--|----------------|-------|---------------------------|-----------------------|
| 1 | Gërmimi i dheut të kat. III, për kanalet e gypave të kanalizimit fekal me thellësi mesatare 2.5m dhe gjërësi 0.80m. Pas montimit të gypave të bëhet kthimi i dheut të gërmuar në kanal duke e ngjeshur dheun në shtresa d=20-30cm. Dheu i tepruar duhet dërgohet në depot. | m ³ | 240 | 2 | 480.00 € |
| 2 | Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit në kanalim e gypave atmosferik. Pozicionet e vendosjes së zhavorit te kanalet të realizohen sipas detajeve në projekt. | m ³ | 160 | 5 | 800.00 € |
| 3 | Blerja, transporti dhe shtruarja e rërës nën. mbi dhe rreth gypave me trashësi 15cm. | m ³ | 45 | 5 | 225.00 € |
| 4 | Ndërtimi i pusetave kontrolluese të kanalizimit me thellësi mesatare 3.50 m. Puseta duhen të jenë të ndërtuara nga elementet e betonit DN-800/1000mm, kurse përfundimi me konus. Puseta kontrolluese të punohen sipas detajeve të dhëna. Llogaria bëhet për copë | copë | 5 | 50 | 250.00 € |
| 5 | Ndërtimi i pusetës kontrolluese për vendosjen e ujëmatësit qëndror prej betoni me shkallë dhe kapak të metalit. | copë | 1 | 50 | 50.00 € |
| 6 | Blerja dhe montimi i gypave PVC të kanalizimit për objektin brenda dhe për largimin e ujërave të kanalizimit fekal dhe atmosferik jashtë objektit dhe pjesëve fazonike, me gjithë materialin e nevojshëm, | | | | |
| 6.1 | Ø50 | m' | 150 | 1 | 150.00 € |
| 6.2 | Ø75 | m' | 190 | 1 | 190.00 € |
| 6.3 | Ø110 | m' | 280 | 1 | 280.00 € |
| 6.4 | Ø125 | m' | 310 | 1 | 310.00 € |
| 7 | Furnizimi dhe montimi ujëmbledhësve të dyshemesë me rrejtë dhe kyçje vertikale në kanalizim; Ø 50mm. | copë | 15 | 5 | 75.00 € |
| 8 | Furnizimi dhe montimi i kokës ventilluese nga liamarina e zinkëtuar 0.35 mm dhe me lartësi H= 1.5 m. Në mbulesën | copë | 3 | 15 | 45.00 € |
| 9 | Shqyrtimi i rrejtit të kanalizimit dhe testimi i rrejtit të kanalizimit në jousjellshueshmëri, gjithnjë sipas kushteve teknike të paraqitura për këtë lloj pune. | m' | 930 | 20 | 18,600.00 € |
| 10 | Kyçja në gypin kryesor të ujësjellësit. Në çmim të llogaritën pjesët fazonike. | komplet | 1 | 50 | 50.00 € |
| 11 | Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave PPRC (Polypropilen) dhe pjesëve fazonike të duhura të ujësjellësit. Në këtë pozicion të futen lidhja dhe të gjitha pjesët fazonike të duhura për lidhje si dhe shqyrtimi në shtypje dhe dezinfektimi i rrejtit. | | | | |
| 11.1 | Ø40-ftohtë | m' | 650 | 1 | 650.00 € |
| 11.2 | Ø25-ftohtë | m' | 500 | 1 | 500.00 € |
| 11.3 | Ø20-ftohtë | m' | 500 | 1 | 500.00 € |
| 12 | Blerja dhe montimi i gypave dhe pjesëve fazonike të duhura, të ujësjellësit. Gypat duhet të jenë të zinkuar Fe Zn. Në çmim të llogaritën të gjitha pjesët fazonike, si dhe shqyrtimi i rrejtit. | | | | |
| 12.1 | Fe Zn Ø63 | m' | 150 | 1 | 150.00 € |
| 12.2 | Fe Zn Ø40 | m' | 120 | 1 | 120.00 € |
| 13 | Blerja dhe montimi i gypave dhe pjesëve fazonike të duhura, të ujësjellësit. Gypat duhet të jenë nga plastika, të futurat në dysheme dhe mur. Në çmim të llogaritën të gjitha pjesët fazonike, si dhe shqyrtimi i rrejtit. | | | | |
| 13.1 | Pex Ø16mm-ujë i ftohtë | m' | 600 | 0.2 | 120.00 € |
| 13.2 | Pex Ø16mm-ujë i nxehtë | m' | 600 | 0.2 | 120.00 € |
| 14 | Furnizimi, transporti, dhe montimi i ormanëve me kolektorë (për ujë të ngrohtë dhe për ujë të ftohtë) me shumë dalje dhe vendosja e tyre në murin e precizuar në vizatime. | copë | 10 | 50 | 500.00 € |
| 15 | Blerja dhe montimi i hidrantëve të jashtëm mbilokësor për shuarjen e zjarrit, DN-50mm. Në çmim të llogaritën të gjitha pjesët fazonike të hidrantit. | copë | 5 | 50 | 250.00 € |
| 16 | Blerja dhe montimi i hidrantëve të brendshëm DN 50 (Ø 63) për shuarjen e zjarrit. Në çmim të llogaritën të gjitha pjesët fazonike të hidrantit (koka, valvula si dhe gypit i hidrantit të jetë L=25m etj). | copë | 6 | 50 | 300.00 € |

| | | | | | |
|----------------|---|---------|-----|----|--------------------|
| 17 | Blerja dhe montimi i fikses së zjarrit. | copë | 10 | 25 | 250.00 € |
| Totali: | | | | | 24.965.00 € |
| 2 | HIDRANTËT | | | | |
| 1 | Furnizimi dhe montimi i gypit të çelikut ZnFe në vertikale dhe horizontale për furnizimin e hidrantëve të brendshëm Ø63mm, duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme fazonike (fiting gypave T vazhduese, kthesa e t.j.) si dhe shtangime të nevojshme, izolim kundër kondensit, mbrojtja nga korodimi dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Llogarite për metër gjatësi të punuar. | m' | 150 | 20 | 3,000.00 € |
| 1.1 | Geberit Mapress T 54x54x54 | copë | 12 | 1 | 12.00 € |
| 1.2 | Geberit Mapress Ms 54-2" FJ | copë | 12 | 1 | 12.00 € |
| 1.3 | Mbajtëse fi 54 | copë | 75 | 1 | 75.00 € |
| 1.4 | Izolim fi 54 | m' | 75 | 1 | 75.00 € |
| 1.5 | Holander 2" | copë | 12 | 1 | 12.00 € |
| 2 | Furnizimi dhe montimi i gypit të çelikut ZnFe në vertikale dhe horizontale për furnizimin e hidrantëve të brendshëm Ø63mm, duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme fazonike (fiting gypave T vazhduese, kthesa e t.j.) si dhe shtangime të nevojshme, izolim kundër kondensit, mbrojtja nga korodimi dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Llogarite për metër gjatësi të punuar. | copë | 11 | 5 | 55.00 € |
| 3 | Gërmimi i dheut për hapja e kanalit me gjerësinë b=50cm, thellësi h=110cm. Planifikimi i sipërfaqes së kanalit dhe mbulimi i tij me ngjeshje adekuare si dhe largimi i dheut të tepert. Llogarite në metër kub të hequr. | m³ | 20 | 5 | 100.00 € |
| 4 | Furnizimi, vendosja dhe planifikimi rërës mbi dhe nën tuba në trashësi 15cm dhe rreth gypit. Llogaritet në metër kub të mbushur. | m³ | 5 | 5 | 25.00 € |
| 5 | Furnizimi dhe montimi i hidrantit të jashtëm nëntakesore me të gjitha pjesët fazonike të hidrantit DN 65/65, kompleti i mbulimit). Ndërtimi i bazamentit me beton armë me dimensione dhe vendosje sipas projektit. Llogarite për cope të kompletuar. | copë | 1 | 5 | 5.00 € |
| 6 | Blerja dhe montimi i aparatit kundër zjarrit "S-9". | copë | 8 | 5 | 40.00 € |
| 7 | Furnizimi dhe montimi i gypave polietilen PE 100 të rrejt të jashtëm të hidrantit me diameter Ø65mm me 10bar shtypje duke përfshirë fazonierin komplet Llogarite në metër gjatësi të montuar. | m' | 25 | 3 | 75.00 € |
| 8 | Shtyrësi i rrejt të ujësllësit të jashtëm me metodën punuese prej 50% me të madh se presioni punues i përvetësuar. | komplet | 1 | 2 | 2.00 € |
| 9 | Testimi i rrejt të hidrantëve komplet | komplet | 1 | 50 | 50.00 € |
| Totali: | | | | | 3,538.00 € |
| 3 | ELEMENTET SANITARE | | | | |
| 1 | Blerja dhe montimi i të guaskës së WC-së geberit, komplet (kazani, gypi, bateritë, etj.). | copë | 12 | 45 | 540.00 € |
| 2 | Blerja dhe montimi i të guaskës së WC-së të rrafshët, komplet (kazani, gypi, bateritë, etj.). | copë | 14 | 45 | 630.00 € |
| 3 | Blerja dhe montimi i të guaskës së WC-së për hendikep, komplet (kazani, gypi, bateritë, etj.), si dhe mbajtësi kanik dhe tëvizës. | copë | 1 | 55 | 55.00 € |
| 4 | Blerja dhe montimi i lavamanit, komplet (bateritë, sifonin, etj.) me pasqyrë. | copë | 32 | 65 | 2,080.00 € |
| 5 | Blerja dhe montimi i lavamanit për hendikep, komplet (bateritë, sifonin, etj.) me pasqyrë me me dimensione 1.0m x 1.0m. | copë | 1 | 75 | 75.00 € |
